



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 44/19
Prishtinë, më 13.02.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës i ftuar: Sokol Havolli (Zv.Guvernator i BQK), Ruzhdi Morina (Kryesues i Bordit të FKPK), Adrian Zalli (Drejtor menaxhues i FKPK), Hajdar Korbi (Anëtar i Bordit FKPK).

Pjesëmarrës tjerë: Violeta Smajlaj (Auditore ZKA), Sylejman Blaku (Gazetar në Kosova Sot), Kreshnik Ymeri (Monitorues nga KDI), Isuf Zejna (Demokracia +), Vatra Qehaja (Këshilltare në GP VV), Halil Berisha (Gazetar i Klan Kosova), Dren Ajeti (Jurist nga Klubi i Prodhuesve), Alberta Hashani (Gazetare në KTV), Shpresë Sejdiu (Asistente në GP-PSD).

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabirje Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetar i Komisionit (tutje Kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Raportim nga Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, lidhur me zhvillimet e fundit të mjeteve pensionale në tregjet financiare;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;**
- 5. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Kostatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;

Kryetari: konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më dt. 19, 27 dhjetor 2018, si dhe 21, 29 dhe 30 janar 2019.

3. Raportim nga Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, lidhur me zhvillimet e fundit të mjeteve pensionale në tregjet financiare

Kryetari: Theksoi se arsya e ftesës së Bordit të Trustit në Komision, është bërë duke parë gjendjen e mjeteve të investuara në tregjet financiare, respektivisht rënien e vlerës së aksioneve në fundvit të mjeteve pensionale të Kosovës, dhe për performacë pozitive në dy muajt e parë të vitit siç ka raportuar Fondi në një dokument që ka përgaditur për komisionin për këtë takim. Si dhe do të na interesojë për hapat që ka ndërmarrë Bordi Drejtues në përgjigjen e krizës për shkak të rënies së vlerës së aksioneve dhe planet dhe angazhimet në menaxhimin e mjeteve si rezultat i lëvizjeve të mundshme që do të mund të ndodhin në të ardhmen në tregjet financiare, dhe garantimi i pensioneve parasegjithash për pensionistët e rinjë.

Ruzhdi Morina: Theksoi se si Bord, ashtu siç bëjmë vazhdimisht dhe që e kërkon ligji, në tremujorin e fundit të vitit kemi informuar Kuvendin me shkrim për gjendjen e mjeteve pensionale që janë nën menaxhim të Fondit. Ajo që duhet të thuhet është se sistemi në menaxhimin e mjeteve pensionale është nën kontroll dhe në këtë drejtim është mirë që mos të ketë raportime që shkaktojnë panik të qytetarët, por të ketë raportime të drejta dhe sakta. Prandaj, bashkëpunimi me mediat, Komisionin, BQK dhe institucionet tjera është i nevojshëm.

Gjatë vitit 2018 janë zvogëluar investimet jashtë vendit dhe janë rritur depozitat në letra me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare brenda vendit. Bord Drejtues ka marrë trembëdhjetë vendime për terheqjen e rreth 581 milion euro nga menaxhuesit specifik të mjeteve, dhe investimin e tyre prej 422 milion euro në menaxhues tjerë, varësisht nga performanca e tyre dhe me qëllim të diverzifikimit në investimin e tyre. Është rritur pjesëmarrja e investimeve në Kosovë nga 11.9% në vitin 2017 në 30.6% në fund të vitit 2018. Rënie të vlerës së aksioneve të mjeteve të investuara në tregjet financiare, ka pasur edhe në fondet e vendeve të zhvilluara, si në Austri kthimi i tyre negativ ka qenë 5.3 %, në Zvicër minus 2%, në Danimarkë ka pasur kthim negativ 1.1%, minus 3% në Holand. Kjo rënie e vlerës së tregjeve financiare ka ndodhur edhe si rezultat i ndikimeve politike globale, si lufta tregtare në mes SHBA- e dhe Kinës, BREX-it.

Ne kemi shpague 31.2 milion euro ndaj atyre që kanë dal në pension, prej tyre 21 milion euro kanë qenë kontribute pensionale, ndërsa 6 milion euro kanë qenë nga investimet. Pra, askush që është pensionuar në vitin 2018 nuk ka humb, natyrisht se e kanë marr fitimin ose kthimin prej 26% që ka qenë mesatarja e kthimit që kanë dal në pension. Në këtë drejtim jemi duke bërë analiza dhe bazuar në kornizën aktuale ligjore, për krijimin e portofoliove të shumëfishta bazuar në grupmoshat që të mbrohen më tepër ata që dalin në pension në vitin e paraqitjes së mundshme të krizave financiare.

Fondi ka përmbyllur vitin 2018 me një rënie të vlerës së aksioneve prej 5.2%. Rënia ka ndodh në muajin dhjetor dhe nëse shikohet historikisht muaji dhjetor ka qenë muaji më i keq. Sa i përket fillim vitit 2019, ne kemi një performacë pozitive në kthimin e mjeteve në investim. Ajo që duhet theksuar se Fondi në pajtim me legjislacionin në fuqi, investimin e mjeteve e bënë në bazë të strategjisë afatgjate dhe shikuar historikisht, në periudha afatgjate, kthimi i mjeteve ka qenë pozitivë. Për 10 vjetët e fundit duke e përfshirë edhe performacën e vitit 2018, del se Fondi ka pasur kthim vjetor mesatar prej + 4.89% ose kthim real prej 3.1% mesarisht në vit.

Kryetari: Pyeti sa është vlera e mjeteve të humbura në dy muajt e fundit dhe sa është rikuperuar vlera e tyre në muajin janar 2019?

Adrian Zalli: Theksoi se rënia në vlerën e aksioneve të mjeteve të investuara në vitin 2018, ka qenë – 84.71 milion euro. Ndërsa, në vlera absolute që është rikuperuar deri më 31 janar 2019 është 55 milion euro. Personat që kanë daluar në pension gjatë vitit 2018, të gjithë janë shpagueur dhe nuk ka pasur humbje në kontributet e tyre. Gjatë vitit kemi pasur 5.491 persona që kanë dal në pension nga këta persona 4.400 kanë qenë në pension të pleqërisë, 867 janë raste të vdekjes, 174 kanë qenë raste invaliditore, 16 % të kontribuesve nuk e arrijn moshën 65 vjeqare dhe kjo shifër është alarmante në proces social.

Kryetari: Ja kalojë fjalën Zv.Guvernatorit të BQK-së për të shprehur opinionin e BQK-së për këtë çështje.

Sokol Havolli: Theksoi se Banka Qendrore e Kosovës në kuadër të kompetencave të veta nëpërmjet procesit mbikëqyrës dhe rregullativ ka pasur komunikim të vazhdueshëm edhe përpara tensionimit të tregjeve globale. BQK zhvillon egzaminime në baza të rregullta në gjithë operatorët në tregun e pensioneve, sikurse në të gjithë operatorët tjerë në industrinë finaciare. Për mjetet pensionale kemi identifikuar disa rreziqe dhe kemi marrë masa afatshkurte dhe afatgjate. Për krizën e fundvitit, siç edhe u tha kjo ka ndodhur për shkak të performancës negative të tregjeve financiare.

Si BQK, jemi të interesuar së bashku me komisioni dhe me Trustin të avancojmë strategjinë investive sidomos në krijimin e portfoliove të shumëfishta të bazuara në grupmoshat më qellim që të ruhen sa më tepër grupmoshat para pensionimit që të mos goditen nga zhvillimet e tregjeve globale financiare.

Kryetari: Në vazhdim parashtrojë disa pyetje për përfaqësuesit e Fondit, si vijon:

Mjetet e Trustit janë të maturuara në periudha afatgjate dhe theksuat se që nga themelimi i tij deri me sot, mjetet e nënmenaxhim të Trustit janë rritur 41%. A është e mjaftueshme kjo rritje. Do të më interesonte krahasimi me fondet e ngjashme të rajoni dhe performanca e tyre si dhe ndikimi negativë që të mund të kenë pasur nga tregjet financiare?

Pyetja e dytë, në observimet që i thatë rreth strategjive të investimeve dhe ndarjes së investimeve në grupmoshat, a ka mundësi që personat që dalin në pension në atë vit kur mund të ndodhin krizat financiare apo rënia e vlerës së aksioneve, të mund të marrin shumën e garantuar (nga ato që ka kontribuar dhe nga kthimi pozitivë që është bërë gjatë viteve)?

Pyetja e radhës është se a ka Bordi i Trustit ndonjë strategji apo formë të përgjigjes së shpejtë në zhvillimet politike që kanë efekt të mundshëm ekonomik dhe financiar dhe si rrjedhojë të rënies së vlerës së mjeteve në tregjet financiare?

Çështja tjetër, a keni bërë ndonjë analizë rreth rrezikut të investimit të mjeteve në mes tregjeve të SHBA-së dhe Evropës? Çështja e fundit a mund të kemi ndonjë raport për zhvillimet e tregjeve, që të mund ti kemi gjërat më nën kontroll dhe të menaxhojmë më mirë dhe më shpejtë me humbjet e Trustit?

Blerim Kuçi: Kemi pas performancë negative të mjeteve nën menaxhim të Trustit edhe në vitin 2008 dhe kjo nuk është përfshirë në analizën tuaj. Ajo që më intereson është fakti nëse Bordi Drejtues ka paraparë ndonjë veprim apo strategji dhe duke u bazuar edhe në krizën e vitit 2008, dhe nëse po cilat veprime i keni ndërmarrë në raportet me krizat në tregjet financiare. Duke pasur parasysh fakti se siguria e mjeteve është elementi kryesorë, cila është strategjia e Trustit për të garantuar sigurinë e mjeteve pensionale?

Arbërie Nagavci: E përmendet se në tremujorin e fundit të vitit të kaluar ka pasur humbje të mjeteve pensionale prej 84 milion euro dhe gjendja është rikuperuar në janar të këtij viti 55 milion euro. A do të thotë kjo sikur mos ti kishim humbur ato 84 milion euro, ne do të kishim 55 milion euro plus. Pra 55 milion euro kthim nuk e kompensojmë humbjen prej 84 milion.

Pyetja e dytë a ka mundësi të na tregoni cilat janë pritshmërit për vitin 2019, dmth në situatën më të mirë dhe më të keqe, kur ndodhin kriza në tregjet globale dhe si i planifikoni investimet? Pyetja e tretë, a keni vlerësuar performancën e aset-menaxherve dhe duke pasur parasysh edhe pagesat e larta për aset

menaxherët, a keni ndërmarrë ndonjë veprim ndaj atyre aset menaxherve që kanë performuar dobët, a keni ndërprerë bashkëpunimin më ata aset menaxher?

Dardan Molliqaj: Shqetësimi im është në performancën e Trustit në përgjithësi. Nëse nuk gabohe m vlera për njësi ka qenë 1 euro në 2003-ten dhe në 2019-ten vlera për njësi ka arritur 1.45 euro. Në qoftëse ka qenë le të themi vlera përfituese 100 euro sot është 141 euro, sipas kesaj logjike nuk jemi tu e mbulue as inflacionin. Pra, në qoftëse është kjo performancë për 15 vite dhe na fund nuk kemi mbulim as të inflacionit, ky është investim totalisht i gabuar në tregjet financiare. Unë besojë se Trusti, BQK dhe institucionet tjera të përfshira të përfshira në menaxhim, ajo që duhet me bë është se si ti bëjmë investimet tona që në totalin e tyre të kenë një vlerë shumë më të madhe.

Naser Osmani: E vërteta është se ka pas një lëvizje negative në bursat ndërkombëtare edhe një ekspert i mirë në këtë fushë nuk mund të përcaktoj dhe parashikojë këto kriza në tregjet financiare. Por ne me ligj, e kemi përcaktuar se ku mund të investohen ato mjete, në institucionet më të sigurta dhe ku është rrezikshmëria minimale. Investimet në tregun e brendshëm apo letrat me vlerë, rritë rrezikun e shtetit me hy ne borxhe më të mëdha.

Ajo që është më e rëndësishme duhet bërë garatimi i mjeteve pensionale të personave mbi moshën 64. Ne duhet të punojmë që mjetet e Trustit të investohen në Kosovë, duhet të gjejmë forma të ndryshme të investimit që të ketë rezultat më të sigurt dhe të investojmë në projektet afatgjate dhe sektorë strategjikë, si në sektorin energjetik.

Safete Hadergjona: Zakonisht kur ka rënie të vlerës së aksioneve të fondit qytetarët janë të elektrizuar ku mediat dhe debatet janë prezente. Ne kemi pas në vitin 2008-2009 rënie të vlerës së aksioneve por që është evidentu 92 milion apo dikun 20 përqind e fondit. Për dallim nga tani në vitin që përmenda ka qenë një problem që janë trondit tregjet financiare në të gjith botën dhe kjo si pasojë ka pas ndikim ndikim në mjetet nën menagjim të Fondit.

Unë e ndëgjova nga kryetari i bordit të Fondit për ndikimet politike në rënien e vlerës së aksioneve, por nuk kemi pasur ndonjë goditje të madhe në tregjet financiare siç ka qenë në vitin 2008-2009. Vet fakti që ka ardh një rënie e tillë e papritur padyshim që ngjall debate dhe shqetësim. Ajo që është diskutuar këtu ndoshta duhet ta shikojmë edhe legjislacionin që ta rregullojm që goditja të mos jetë për ata që dalin në atë periudhë kohe në pension, që të mos ta marrin barrën e dëmtimit për shkak të rënies së aksioneve. Kryesorja është që mjetet me qenë të sigurta.

Nga raporti që kemi marr nga Fondi kemi parë që mjetet janë të investuara në dhjetra vendet e botës , përfshirë edhe në tregjet apo vendet jo të sigurta, siç është Greqia. Kur të sjellini raportin e radhës është mirë me specifiku saktësisht se cillat tregje kanë pasur rënie që ne me pasur një pasqyr më të detajizuar meqenë se ne jemi institucion që ju mbikëqyrim dhe ua caktojm tarifat menagjuese. Të shofim ne si Kuvend që rastet e tilla të mos përsëriten. Mirëpo përgjegjsia bie tek ju si Fond që merreni me menagjimin e këtyre mjeteve pensionale.

Ruzhdi Morina: Investimet tona bëhen në përputhshmëri me kornizën ligjore. Mundësit maksimale të investimeve në Kosovë i kemi shfrytëzuar që për ne konsiderohet me rrezik zero. Pjesa tjetër është e ekspozuar në tregje financiare ndërkombëtare. Ne jemi të gatshëm të investojmë në projekte të mëdha vendore me kthim të mirë të investimeve. I kemi dy vende si Kroacia dhe Maqedonia që nuk i ka prekur kriza e fundit, për shkak se mjetet pensionale i kanë të investuar në projektet strategjike brenda vendit.

Viti 2008 e ka godit Fondin me 29 apo 30 përqind dhe në shifra nominale ka qenë 92 milion euro, vlera e aksionit ka qenë 0.80 përqind dhe për 10 vite vlera a aksioneve ka pasur ngritje në 1.45 – 1.47 dhe është rritur mbi 61 përqind.

Ne brenda vitit duhet të implementojm portofole të shumfishta, sa i përket grupmoshave personat mbi 62 pretendojmë ti kalojmë në një portofolie të sigurt, në vlerë me letra të vendit tonë e cila nuk rrezikohet ajo që kanë akumuluar gjatë gjithë jetës. Vendimarrja nuk është problem, por zbatimi i sistemit të IT-së është më komplekse për ti ndarë në grupmosha. Kemi pasur problem me sistemin e IT-se rreth 6 muaj.

Jemi përfshirë në ligjin për prokurimin publik pa të drejtë. Jemi përfaqësues të skemës pensionale me 1.7 miliard euro nënmenaxhim dhe nuk jemi konsultuar rreth platformës për skemat pensionale dhe reformat pensionale. Sa i përket së vlerës e inflacionit, ne e kemi ruajtur vlerën dhe e kemi tejkaluar inflacionin. Jemi një ndër institucionet e vetme që nuk kemi asnjë vërejtje nga auditori.

Kryetari: Zotëri Zalli, në fillim Trusti ka nisur me koeficient 1, ndërsa për periudhën 16 vjeçare mjetet janë rritur për 41 përqind, në qoftëse këto të holla i kishte pas Kosova në Fodin pensional të Kroacisë ose Sllovenisë ose Maqedonisë, për sa ishin rritur?

Adrian Zalli: Sa i përket fondeve në rajon, fillimi i tyre ka qenë më ndryshe se i joni. Ata e kanë pasur obligim ligjor që 50-80 përqind të fondeve të tyre për të investuar në kuadër të boneve të qeverisë së tyre. Kroacia ka pasur projekte të mëdha infrastrukturore dhe kthimi i garantuar diku 6 përqind. Investimi bëhet në valutë të tyre. Kthimi për 10 vitet e fundit në Kroaci ka qenë rreth 80 përqind në krahasim me të Kosovës më 61 përqind. Mirëpo, Kroacia kur ka hyrë në Europë ka qenë e obliguar ta shfuqizon ligjin e paraparë për shkak të diskriminimit të konkurrencës dhe si rezultat kthimi ka rënë relativisht shumë. Nëse krahasojmë me Austrinë, kthimi ka qenë negativ ekzaktë sa edhe i joni. Nëse e shikojmë vitin 2017 kthimi ka qenë më i ultë se sa i Kosovës.

Sa i përket inflacionit, nëse e marrim për 10 vitet kthimi i ynë real është 3.81 përqind mbi inflacionin. Tri vitet e para të themelimit, Trusti ka qenë në konsolidim, ka pas jashtëzakonisht shumë pak asete.

Sa i përket pyetjes së zotit Kuçi ne e kemi një strategji të investimeve të publikuar në web faqen tonë, bordi atë i shikon në çdo takim e cila i ka targetet e veta për secillën klasë të aseteve dhe në bazë të intervistave që zhvillojmë me aset menaxherët dhe profesionalizimit të anëtrëve të bordit, vendosim për lëvizshmërinë e tyre. Gjatë vitit 2018 kemi levizur rreth 500 milion euro nga aset menaxherët e ndryshëm. Pra ne bëjmë vlerësimin e performacës së aset menaxherëve që është edhe përgjigja në pyetjen e zonjës Nagavci.

Kryetari: Ju lutem të bëni një analizë rreth zhvillimeve politike në Europë, cilat hapa do të kishit ndërmarrë si Bord nëse nesër kemi Brexit? Çfarë implikime do të kemi në tregjet financiare, a kemi ndonjë masë që të minimizojmë riskun apo thoni ndodhi një krizë, por afatgjatë jemi mirë?

Ruzhdi Morina: Një prej masave paraprake që kemi marrë është zvogëlimi i ekspozimit në Evropë dhe ma shumë jemi duke u ekspozuar në SHBA. Jemi duke analizuar se si do të ndikojë Brexit-i në tregjet financiare.

Adrian Zalli: Është jashtëzakonisht vështirë me kriju strategjinë apo me marrë paravendime për gjërat që janë politike. Çka ne e dijim papunësia është e ultë dhe ekonomia në SHBA relativisht mirë, prandaj është vendosur të investohen mjetet në SHBA.

Blerim Kuçi: A ka të parapara Trusti procedura apo masa të veprimit të mjeteve dhe kur ndodhin kriza të ngjashme me ditë veprimin e parë, dytë apo tretë. Kjo është në interes edhe për ne për të mundur me monitorue më mirë punën tuaj. Ajo që kërkojmë nga ju, të bëni rekomandime që kanë bëjnë me nevojë e ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve dhe procedura e ligjore, dhe të kërkon nga ne që të intervenojmë që është në funksion të rregullimit të kësaj fushe dhe në interes të ruajtjes së mjeteve pensionale.

Ali Lajci: Kishte qenë qasje e mirë për buxhetin të Trustit duke pasur parasysh nivelin e tregjeve dhe aksioneve nga trendi negativë i këtyre dy viteve të fundit. A ka ndonjë mundësi, duke pas parasysh në menaxhimet eventuale që buxheti i Trustit të perfitoj nga ndonjë organizatë apo ndonjë shfrytëzim tjetër.

Ruzhdi Morina: Është praktikë që në raportin vjetor ti paraqesim edhe rekomandimet për kornizën ligjore, dhe aty do të keni të dhëna të specifikuar për punën e vitit 2018.

Adrian Zalli: Përkundër faktit çfarë ka ndodhur në tregjet financiare, është një rrugë e ngushtë në mes balancimit të riskut dhe kthimit të mjeteve. Në Kroaci, përveç efekteve pozitive, borxhi publik është rritur 80% e GDP-së.

Sokol Havolli: Jemi duke zhvilluar kornizën ligjore për themelimin e fondeve të investimit financiar me qëllim që të krijohen instrument dhe mekanizma për investime të reja, jo vetëm për mjetet pensionale, por të cilido qytetar që ka kapacitete investive.

Kryetar: Kërkojnë nga Fondi Pensional ti dërgojë komisionit, përgjigjet me shkrim në pyetjet dhe çështjet e ngritura dhe pjesë e raportit të jetë edhe pritjet tuaja për zhvillimet politike në BE dhe SHBA. Si dhe të ketë intensifikim të takimeve të ngjashme në të ardhmen, me Trustin dhe BQK dhe të na njoftoni për çdo alarm apo situatë që gjenjen e mjeteve që paraqitet në të ardhmen.

4. Shqyrtimi i Raporti plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryetari: Theksoi se amendamentet e propozuara nuk përbajnë implikime buxhetore shtesë.

Safete Hadergjonaj : Theksoi se ne kemi pasur në komision një kërkesë për çështjen e kompensimit të Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit për Shërbimet e Ujit dhe përkundër që kryesuesi është emëruar nga Kuvendi, i njëjti që dy-tre vite nuk është kompensuar fare. Nëse personi nuk ka punë, nuk duhet ta lëmë fare në ligj. Nëse ka punë duhe rregulluar pagesën. Ndoshta është mirë ta shohim në këtë projektligj se si të rregullojmë këtë çështjen e kompensimit të Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit për Shërbimet e Ujit.

Kryetari konstatoi se komisioni autorizojë zëvendëskryetaren e parë të komisionit, që të analizojë dhe të bëjë propozime lidhur me çështjen e kompensimit të Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit për Shërbimet e Ujit dhe më pas ti dërgojmë komisionit funksional si amendament tonin.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Amendamenti i propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe amendamenti i propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, nuk përbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256

Kryetari konstatoi se në bazë të propozimit, Komisioni formojë Grupin Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-

256, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Mërgim Lushtaku, Arbërie Nagavci, Dardan Molliqaj dhe Fikrim Damka.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:34.
Përgatitur nga njësi mbështetëse e komisionit**

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku